



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “FAN S. NOLI”
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA**

RAPORT SHKENCOR (STUDIMI) I PROJEKTIT

“Nga projekti drejt të mësuarit me kompetencën digjitale DIGICOMP”

Drejtori i Institucionit Shkencor

Prof. Dr. Dhimitri Bello

Autorë

**Dr. Erinda Papa
Dr. Eriola Qafzezi
Phd. Daniela Stoica**

Korçë, Tetor, 2023

TABELA E PËRMBAJTJES

LISTA E SHKURTESAVE TË PËRDORURA.....	3
LISTA E ILUSTRIMEVE	4
KREU I	5
I.1. HYRJE.....	5
I.2. Qëllimi i Projektit.....	5
I.3. Objektivar e projektit.....	6
I.4. Përfituesit e projektit.....	12
I.5. Rezultatet e projektit.....	13
KREU II: PRITSHMËRITË E TREGUT TË PUNËS NË LIDHJE ME KOMPETENCAT E FITUARA NGA TË DIPLOMUARIT E UNIKO.....	16
II.1. Analiza e programeve të kërkuara në tregun e punës në Shqipëri	16
<i>II.1. 2.Metoda e studimit</i>	<i>16</i>
<i>II.1. 3.Analiza e gjetjeve</i>	<i>17</i>
KREU III: MASAT E MARRA PËR TË RRRITUR CILËSINË DHE KOMPETENCAT E TË DIPLOMUARVE DHE TË TË PUNËSUARVE NË PËRPUTHJE ME NEVOJAT DHE KËRKESAT E TREGUT	32
III.1. Identifikimi qendrave të ngjashme dhe vlerësimi i nevojave në fushën e edukimit digjital	33
III.2. Hartimi i programit të trajnimit dhe kualifikimit.....	34
III.3. Organizimi i kurseve të trajnimit dhe kualifikimit	35
III.4. Organizimi i simpoziumit shkencor.....	38
PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....	39
LITERATURA	43
ANEKS 12/1.....	46
ANEKS 12/4.....	47

LISTA E SHKURTIMEVE TË TERMAVE TË PËRDORURA

AKKSHI – Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit

PKZH – Projektet Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit

UNIKO – Universiteti i Korçës

AUF - Agjencia Universitare e Frankofonisë

DRAP – Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar

PTK - Programi i trajnimit dhe kualifikimit

IAL – Institucione të Arsimit të Lartë

LISTA E ILUSTRIMEVE (FIGURA, GRAFIKË, HARTA, SKICA, ETJ.)

Fig 1: Përputhshmëria e njohurive të fituara në studime me kërkesat e vendit të punës sipas sektorit ku operon biznesi

Fig 2: Përputhshmëria e aftësive të fituara në studime me kërkesat e vendit të punës sipas madhësisë së biznesit

Fig 3: Përputhshmëria e kompetencave të fituara në studime me kërkesat e vendit të punës sipas sektorit ku operon biznesi

Fig 4: Përqindja bizneseve në vlerësimin e rëndësisë së kompetencave në shkallën nga 1-13 (1 më i rëndësishmi; 13 më pak i rëndësishëm)

Fig 5: Programet e kërkuara nga bizneset sipas fushave të veçuara për studim

Fig 6: Programet e kërkuara nga sektori publik dhe OJQ-të sipas fushave të veçuara për studim

Fig 7: Kompetencat më të rëndësishme sipas statusit ligjor të biznesit

Fig 8: Kërkesa e bizneseve për nivel njohurish, aftësish/shkathtësish

Fig 9: Perceptimi i bizneseve lidhur me përputhshmërinë e programeve me nevojat e tregut të punës dhe vlerësimi për ndikimin e kompetencave në mundësinë e punësimit.

Fig 10: Njohja e kurrikulave nga bizneset në Shqipëri

Fig 11: Pjesëmarrja në diskutime të hartimit të kurrikulave sipas statusit ligjor të firmës

Fig 12: Perceptimi i bizneseve për ndikimin e bashkëpunimit në rritjen e normës së punësimit dhe shkurtimit të periudhës tranzitore diplomim – punësim

Fig 13: Perceptimi i bizneseve për dobinë e kompetencave të përgjithshme krahasuar me përfshirjen e këtyre kompetencave në programe nga IAL-të dhe perceptimi për arritjen e tyre nga të diplomuarit.

Fig 14. Përputhja e kompetencave me kërkesat e vendit të punës

Fig 15. Përputhja e kompetencave specifike me kërkesat e vendit të punës

KREU I

I.1. Hyrje

Niveli arsimor i një shoqërie përbën një përcaktues të fuqishëm si të performancës së tregut të punës, ashtu edhe të varfërisë së saj. Reformat e kryera gjatë viteve të fundit kanë bërë hapa të rëndësishëm në drejtim të rritjes së treguesve sasiorë të arsimit në të gjithë nivelet. Megjithatë, një gjë e tillë duhet të përputhet tërësisht me rritjen e cilësisë, dhe më e rëndësishmja, me lidhjen e rezultateve arsimore kundrejt nevojave të tregut të punës. Projekti i financuar nga AKKSHI, nën thirrjen e PKZH 2021-2023, shënoi një përpjekje për të shndërruar Laboratorin e gjuhëve të huaja, FEF, në një qendër kualifikimi dhe formimi të vazhduar me qëllim edukimin me kompetencën digjitale që të shmanget mospërputhja e aftësive të të diplomuarve në programet e gjuhëve të huaja në rajonin e Korçës, e cila paraqitet në dy forma:

- i. Mbikualifikimi: pra individë që punojnë në profesione për të cilat janë të mbikualifikuar, ose në fusha që nuk kanë lidhje me fushën e tyre të studimit; dhe
- ii. kualifikimi i ulët që rrjedh nga mangësitë në aftësim, të cilat bëjnë që punëdhënësit të punësojnë punëtorë, që nuk janë më të përshtatshmit për punën e cila u ofrohet.

Programet Kombëtare të Kërkimit dhe të Zhvillimit janë paraqitje sintetike e veprimtarive sistematike kërkimore dhe zhvillimore, që ndërmerren për të arritur objektiva të caktuar në kërkimin shkencor dhe zhvillimin teknologjik me rendësi për përparimin e vendit. Ato mbështesin në aspektin kërkimor dhe zhvillimor Programin e Qeverisë për zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe kulturor të vendit. PKKZH zbatohen nëpërmjet projekteve të kërkimit dhe zhvillimit.

Në përgjigje të kushteve dhe kritereve të përcaktuara në thirrjen e shpallur nga AKKSHI, departamenti i Gjuhëve të Huaja, UNIKO, hartoi projektin me temë **“Nga projekti drejt të mësuarit me kompetencën digjitale”**.

I.2 Qëllimi i Projektit (Shqip dhe anglisht)

Qëllimi i projektit është të ofrojë zgjidhje praktike në mënyrë që të ndihmojë në mbylljen e hendekut midis nevojave / pritjeve të tregut dhe rezultateve të sistemit arsimor, duke krijuar një program trajnimi dhe kualifikimi për të gjithë mësuesit e gjuhëve të huaja në shërbim, mësuesit e ardhshëm të gjuhëve të huaja në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, specialistët IT për të dizenuar module trajnimi për faqe ëeb në gjuhën e huaj, grupe interesi nga komuniteti për të përftuar shërbime trajnimi të lidhura me gjuhët e huaja për qëllime specifike, si dhe specialistët e shërbimeve arsimore për të hartuar politika në lidhje me edukimin digjital. Në këtë kontekst, grupi i punës hartëzoi praktikat më të mira nga vendet e rajonit dhe më gjerë në ofrimin e shërbimeve të tilla nga laboratorët apo qendrat e gjuhëve të huaja,

(https://drive.google.com/file/d/1livCo_7ZzTLMmrHTJ0yrdM_VaQxumHJM/view?usp=sharing) me qëllim hartimin e një programi trajnimit dhe kualifikimit bashkëkohor dhe të përafrueshëm me sistemin arsimor evropian.

AIM OF THE PROJECT: The aim of the project is to offer practical solutions to help close the gap between market needs/expectations and the outcomes of the education system. This can be achieved by creating a training and qualification program for all in-service foreign language teachers, future foreign language teachers at all pre-university education levels, and IT specialists who will design training modules for foreign language websites. Additionally, stakeholders from the community will benefit from language-related training services for specific purposes. Specialists in educational services will also contribute to formulating policies related to digital education. In this context, the working group has outlined best practices from the region and beyond in providing such services from language labs or foreign language centers, aiming to develop a contemporary and compatible training and qualification program with the European education system.

(https://drive.google.com/file/d/1livCo_7ZzTLMmrHTJ0yrdM_VaQxumHJM/view?usp=sharing)

I.3. Objektivat e projektit (Shqip dhe anglisht)

Duke synuar një mjedis virtual të nxëni, i cili promovon *qëndrueshmërinë* si strategji zhvillimi dhe *cilësinë* si strategji integrimi, grupi i përbashkët i punës hartoi një plan veprimi për zhvillimin e programit, ku u përcaktuan **objektivat strategjikë specifikë** dhe masat për realizimin e tyre.

1. Hartimi i një programi trajnimit dhe kualifikimit bashkëkohor në fushën e edukimit digjital, duke ndihmuar kështu në ndërtimin e kapaciteteve të departamentit të Gjuhëve të Huaja, në përmirësimin e nivelit të aftësive dhe kompetencave të ofruara nga një institucion i arsimit të lartë dhe në adresimin e mungesës ekzistuese të programeve të ngjashme.
2. Vendosja e lidhjeve dhe e urave të bashkëpunimit me sistemin arsimor parauniversitar në të gjitha nivelet, duke ofruar shërbime trajnimit dhe kualifikimi me kompetencën digjitale për mësuesit e gjuhëve të huaja, si dhe me grupet e tjera të komunitetit nëpërmjet shërbimeve të ofruara nga Laboratori i gjuhëve të huaja si një mjedis virtual të nxëni.
3. Rritja e kapaciteteve infrastrukturore të departamentit të Gjuhëve të Huaja nëpërmjet shndërrimit të laboratorit në një mjedis virtual të nxëni, me emërtimin Qendër e gjuhëve të huaja, e cila do të veprojë si një vatër kërkimi dhe inovacioni duke siguruar që edukimi digjital të vazhdojë të mbetet në qendër të veprimtarive të këtij departamenti edhe pasi ky projekt të ketë përfunduar.

4. Rritja e kapaciteteve njerëzore të departamentit të gjuhëve të huaja, nëpërmjet krijimit të një mjedisi virtual trajnimi në mbështetje të stafit akademik gjatë dhe pas përfundimit të projektit.
5. Krijimi i kushteve për gjenerimin e të ardhurave nga shërbimet e ofruara nëpërmjet kësaj qendre.



Objektivi 1 adreson nevojën për hapa konkretë drejt krijimit të një ekosistemi arsimor ndërkurrikular. Grupi i punës synoi të shkojë përtej thjesht hartimit të një programi trajnimi, por më tepër drejt një metodologjie për hartimin e një programi për avancimin në karrierë të mësuesve të gjuhëve të huaja dhe specialistëve të interesuar për çështje arsimore, si dhe të anëtarëve të komunitetit për kurse të specializuara në gjuhën e huaj përmes edukimit digjital.

Objektivi 2 adreson nevojën për ruajtjen dhe forcimin e lidhjeve me të gjitha hallkat e sistemit arsimor parauniversitar dhe anëtarët e tjerë të komunitetit të interesuar për trajnime me kompetencën digjitale.

Objektivat 3 dhe 4 janë një përgjigje e drejtpërdrejtë kundrejt nevojës për ofrimin e kapaciteteve të nevojshme në fushën e edukimit digjital. Nëpërmjet krijimit të një inkubatori virtual të nxëni për transferimin e njohurive në synojmë të plotësojmë nevojat e komunitetit për shërbime të ofruara në fushën e edukimit digjital. Për rrjedhojë nëpërmjet rritjes së kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturore u synua drejt krijimit të një rrjeti mësimdhënësish të gjuhëve të huaja të kualifikuar me kompetencën digjitale dhe aftësi profesionale. Botimi i librit të bardhë do t'u vijë në ndihmë të gjithë të interesuarve për t'u bërë pjesë e këtij mjedisi virtual formimi të vazhduar.

Organet e financimit të projektit ishin AKKSHI, UNIKO dhe Agjencia Universitare e Frankofonisë (AUF).

Zbatimi i projektit solli përmirësimin e linjave të bashkëpunimit me DRAP Korçë dhe drejtoritë e shkollave të arsimit parauniversitar të rajonit të cilat nuk nguruan jo vetëm t'i përgjigjeshin thirrjes së departamentit për trajnimin e mësuesve në detyrë, por edhe për të ofruar rekomandime të frytshme mbi nevojat për fushat e trajnimit në edukimin digjital. Me shumë vlerë ishte edhe bashkëpunimi me Agjencinë Universitare të Frankofonisë. Gjatë aplikimit të projektit doli si domosdoshmëri njohja e stafit të departamentit me mjetet e fundit tteknologjike të përdorura të përdorura gjatë mësimdhënies/nxënies së gjuhëve të huaja. Për këtë qëllim, kjo agjenci mundësoi zhvillimin e disa seminareve trajnuese të zhvilluara nga staf i kualifikuar shqiptar dhe i huaj.



Zoom Meeting

Erinda Papa Anida Kisi Fabiola Kadi Olsa Eriola Qafzezi Benita Stavre

padlet.com/foucherannelaure/66k58h3pgg1gwoda

padlet

Anne-Laure + 28 · 9 mois

VADIM 2021

Visioconférences pour l'Apprentissage de la langue, Dispositif Interculturel et Multimodal (Université Clermont Auvergne / Université de Tirana / Université Sapientza)

Présentation de VADIM 2021

Composition des petits groupes de visioconférence

Qui sont les tutrices et les tuteurs ?

Liens vers les padlets des tutrices et tuteurs

Anonyme 10 mois

Bonjour !

Je m'appelle Sandro, j'ai 20 ans et je suis en master de didactique du français. J'adore découvrir les langues et les cultures du monde. J'aimerais devenir professeur de français.

Anonyme 10 mois

<https://padlet.com/sandrogalle03/2948otpa8320v8y1>




Foto nga trajnimet e zhvilluara nga AUF me stafin e Departamentit.

OBJECTIVES

Aiming at a virtual learning environment that promotes sustainability as a development strategy and quality as an integration strategy, the joint working group outlined an action plan for the development of the program. This plan indicated specific **strategic objectives** and measures for their implementation.

1. Development of a contemporary training and qualification program in the field of digital education, thereby assisting in building the capacities of the Foreign Languages Department. This aims to enhance the level of skills and competencies offered by a higher education institution and addresses the existing lack of similar programs.
2. Establishing connections and collaborative avenues with the pre-university education system at all levels by offering digital competency training and qualification services for foreign language teachers. This includes extending these services to other community groups through offerings from the Foreign Language Laboratory as a virtual learning environment.

3. Enhancing the infrastructure capacities of the Foreign Languages Department by transforming the laboratory into a virtual learning environment, named the Foreign Language Center. This center will operate as a hub for research and innovation, ensuring that digital education remains at the core of the department's activities even after the completion of this project.
4. Increasing the human capacities of the Foreign Language Department through the creation of a virtual training environment to support academic staff during and after the project's completion.
5. Creating conditions for generating revenue from the services offered through this center.

Objective 1 addresses the need for taking concrete steps towards creating an interdisciplinary educational ecosystem. The working group aimed to go beyond merely developing a training program but focusing instead on a methodology for creating a career advancement program for foreign language teachers and education professionals. Additionally, the objective extends to community members interested in specialized courses in foreign languages through digital education.

Objective 2 aims to preserve and strengthen connections with all components of the pre-university education system and other community members interested in digital competency training.

Objectives 3 and 4 directly respond to the need for providing necessary capacities in the field of digital education. Through the creation of a virtual learning incubator for knowledge transfer, the goal is to fulfill the community's needs for services in digital education. Consequently, by increasing human and infrastructural capacities, efforts are directed towards establishing a network of qualified digital competency and professionally skilled foreign language educators. The publication of the book of best practices (the white book) will assist all interested parties in becoming part of this continuous virtual learning environment.

The project's funding bodies were NASRI, UNIKO, and the Francophone University Agency (AUF). The project implementation led to improved collaboration with the Directorate of Pre-University Education, Korçë and the pre-university education school authorities in the region. They not only responded to the department's call for in-service teacher training but also offered valuable recommendations on the needs for digital education training areas. Collaboration with the Francophone University Agency was highly appreciated. During the project application, it became necessary for the department staff to familiarize themselves with the latest technological

tools used in foreign language teaching/learning. For this purpose, the agency facilitated the development of several training seminars conducted by qualified Albanian and foreign staff.

I.4. Përfituesit e projektit

1. Përfituesit direkt

Përfitues direkt të këtij projekti ishin mësuesit e gjuhëve të huaja në rajonin e Korçës, individët me shpirtin e sipërmarrjes për të modeluar dhe hedhur në treg kurse trajnimi, specialistët e institucioneve mbështetëse arsimore të interesuar në fushën e edukimit digjital, si dhe të gjithë anëtarët e komunitetit të interesuar për ndjekjen e kurseve të gjuhëve të huaja të dhëna përmes platformave elektronike.

2. Përfituesit indirekt

Nëpërmjet këtij projekti, do të përfitojnë të gjitha hallkat në UNIKO në ofrimin e shërbimeve më të mira, në zgjerimin e programeve të trajnimit dhe kualifikimit të mësuesve në detyrë, në rritjen e bashkëpunimit me palë të treta interesi. Nga rezultatet e këtij projekti u përmirësuan kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturore të UNIKO.

Personeli që u përfshi në zbatimin e projektit:

Grada shkencore	Emër mbiemër	Institucioni	Detyrat në projekt
Phd.	Daniela Stoica	UNIKO ¹	Analiza e tregut të kurseve të trajnimit profesional Rritja e bashkëpunimit nderinstitucional nepermjet lidhjes se marreveshjeve perkatese; trajner
Dr.	Erinda Papa	UNIKO	Drejtuues projekti
Dr.	Eriola Qafzezi	UNIKO	Hartimi i programeve të trajnimit; trajner
Dr.	Juliana Çyfeku	UNIKO	Hartimi i programeve të trajnimit; trajner
Dr.	Fabiola Kadi	UNIKO	Sigurimi i cilesise dhe monitorimi; trajner
Dr.	Lindita Kaçani	UNIKO	Miratimi i programit të kualifikimit dhe trajnimit; trajner
Dr.	Dorela Kaçani	UNIKO	Hartimi i programeve të kualifikimit; trajner
Dr.	Lorena Robo	UNIKO	Hartimi i programeve të kualifikimit; trajner

¹ UNIKO – Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë

Dr.	Olsa Pema	UNIKO	Hartimi i programeve te kualifikimit; trajner
	Dhimitri Konini	UNIKO	IT, Trajner
	Klajdi Qafzezi	UNIKO	IT, Trajner

Projekti filloi zbatimin në tetor 2021 dhe u mbyll në shtator 2023 duke realizuar të gjitha veprimtaritë e parashikuara në përmbushjen e objektivave të synuara. Përfitues direkt të këtij projekti ishin mësuesit e gjuhëve të huaja në rajonin e Korçës, individët me shpirtin e sipërmarrjes për të modeluar dhe hedhur në treg kurse trajnimi, specialistët e institucioneve mbështetëse arsimore të interesuar në fushën e edukimit digjital, si dhe të gjithë anëtarët e komunitetit të interesuar për ndjekjen e kurseve të gjuhëve të huaja të dhëna përmes platformave elektronike. Nëpërmjet këtij projekti, përfituan të gjitha hallkat në UNIKO në ofrimin e shërbimeve më të mira, në zgjerimin e programeve të trajnimit dhe kualifikimit të mësuesve në detyrë, në rritjen e bashkëpunimit me palë të treta interesi. Nga rezultatet e këtij projekti u përmirësuan edhe kapacitetet njerëzore dhe infrastrukturore të UNIKO.

I.5. Rezultatet e projektit (Shqip dhe anglisht)

Programi i trajnimit dhe kualifikimit me kompetencën digjitale (PTK) i shtrin efektet e tij drejtpërdrejt në UNIKO dhe në rajonin e Korçës, por do të ketë gjithashtu një ndikim më të gjerë dhe të mëtejshëm mbi studentët, stafin akademik dhe administrativ, shkollat, politikëbërësit dhe iniciativat SMS .

Kurrikula e këtij programi trajnimi dhe kualifikimi, me fokus ndërdisiplinar lidh së bashku disiplinat e Shkencës dhe Arteve për të ndarë njohuritë, praktikat dhe për të provuar proceset me qëllim gjetjen e mënyrave inovative për ta përshtatur formimin e mësuesve të gjuhëve të huaja, por jo vetëm, me nevojat e kohës; qasja digjitale e të mësuarit dhe të nxënit të gjuhëve të huaja u mundëson mësimdhënësve të lidhin metodat e të mësuarit me parimet e dizajnit dhe standardet e qasjes online, për të plotësuar hendekun mes formimit të mësuesve dhe nevojave të tregut. Kurrikula e këtij programi trajnimi dhe kualifikimi heq kufizimet tradicionale dhe i zëvendëson ato me instrumenta krijues, kritikë, analitikë dhe inovatorë.

PTK ndihmon gjithashtu në lidhjen më të mirë mes teorisë dhe praktikës në fushën e edukimit digjital përmes kërkimit dhe mësimin me cilësi të lartë duke shfrytëzuar Laboratorin e Gjuhëve të huaja tashmë të shndërruar në një mjedis virtual të nxëni. Të gjitha grupet e synuara do të jenë në gjendje të zhvillojnë kompetenca profesionale, praktikë reflektuese, mendje sipërmarrëse, duke i pajisur ata me aftësi për t'iu përshtatur ndryshimeve të vazhdueshme në tregun e punës.

Ky program do të ketë ndikim **në të ardhmen** edhe në trajnimin e vazhduar të stafit akademik dhe në rritjen e kapaciteteve infrastrukturore të UNIKO. Ai do të ketë një ndikim pozitiv:

- në nivel institucional, pasi do të zgjerojë numrin e programeve të ofruara nga UNIKO për formimin e vazhduar të mësuesve në detyrë;

- në nivel komunitar, si rezultat i përdorimit të programeve digjitale nga institucionet arsimore, individët me shpirtin e sipërmarrjes dhe specialistët e arsimit dhe teknologjisë në këtë fushë studimi.

Programi i trajnimit dhe kualifikimit do të ndihmojë jo vetëm në prodhimin dhe shpërndarjen e burimeve dhe ideve, por gjithashtu edhe në formimin e politikave duke bërë bashkë institucionet politikbërëse dhe institucionet e arsimit të lartë. Hendeku midis industrisë dhe arsimit do të zvogëlohet duke promovuar dhe mbështetur në mënyrë aktive trajnimin e mësuesve në të gjitha nivelet, përfshirë edhe trajnimin brenda UNIKO.

Ky program do të ndikojë si tek nxënësit e të gjitha niveleve ashtu edhe tek stafi akademik i UNIKO.

- Nxënësit do të kenë një qasje të re të të mësuarit të gjuhëve të huaja në përputhje me instrumentet bashkëkohore digjitale;
- Stafi akademik do të përballlet me një metodologji të re dhe ndërdisiplinore të të nxënësve, si dhe me praktika të reja të të mësuarit përmes sistemeve digjitale.

Ky program do të zbatohet i lidhur ngushtë edhe me objektivat strategjike të UNIKO me fokus rajonalizimin, duke krijuar rrjete mësimdhënësish dhe nxënësish të gjuhëve të huaja, gjë që do të rritë mundësitë e shkëmbimit të praktikave më të mira.

PROJECT RESULTS - Specifically, the Digital Competency Training and Qualification Program (PTK) has direct effects on UNIKO and the Korça region, but it will also have a broader and lasting impact on students, academic and administrative staff, schools, policymakers, and SMS initiatives.

The curriculum of this training and qualification program, with an interdisciplinary focus connecting the disciplines of Science and Arts to share knowledge, practices, and test processes, finds innovative ways to adapt the training of foreign language teachers, and more, to the needs of the time. The digital approach to language learning enables educators to connect learning methods with design principles and online access standards to bridge the gap between teacher training and market needs. The curriculum of this training and qualification program removes traditional limitations and replaces them with creative, critical, analytical, and innovative tools.

PTK also helps better link theory and practice in the field of digital education through research and high-quality learning using the Foreign Language Laboratory already transformed into a virtual learning environment. All targeted groups will be able to develop professional competencies, reflective practices, entrepreneurial thinking, equipping them with the ability to adapt to continuous changes in the job market.

This program will also impact **the future** continuous training of academic staff and the increase in infrastructural capacities at UNIKO. It has a positive impact:

- At the institutional level, by expanding the number of programs offered by UNIKO for in-service teacher continuous training.

- At the community level, as a result of the use of digital programs by educational institutions, individuals with entrepreneurial spirit, and specialists in education and technology in this field of study. The training and qualification program will not only assist in the production and dissemination of resources and ideas but also in policy formation by bringing together policymaking institutions and higher education institutions. The gap between industry and education will be decrease by actively promoting and supporting teacher training at all levels, including training within UNIKO.

This program will impact both students at all levels and the academic staff of UNIKO.

- Students will have a new approach to learning foreign languages in line with contemporary digital tools.
- Academic staff will face a new and interdisciplinary methodology of learning, as well as new learning practices through digital systems.

This program will be closely tied to UNIKO's strategic objectives, focusing on regionalization, creating networks of foreign language educators and students, which will increase opportunities for the exchange of best practices.

KREU II

PRITSHMËRITË E TREGUT TË PUNËS NË LIDHJE ME KOMPETENCAT E FITUARA NGA TË DIPLOMUARIT E UNIKO

Çdo vend ka nevojë që të ndërtojë një sistem menaxhimi, zhvillimi dhe përparimi njohurish, përmes të cilit mund të arrihen nivele të larta zhvillimi ekonomik dhe shoqëror. Kjo funksionon para se gjithash kur kuptohen drejt kërkesat e tregut të punës dhe kur arrihet që këto kërkesa të përkthehen në rezultate të pritshme nga një proces arsimor përkatës. Njohuritë dhe kompetencat që zhvillohen në universitete, institucione kërkimore, por edhe në ndërmarrje apo nga qeveria e një shteti kanë kuptim nëse ato përdoren për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të një vendi dhe janë të tilla nëse zbatohen në procese që krijojnë vlera. Këto vlera arrihen kur produktet dhe shërbimet që i ofrohen kërkesës në treg janë rezultat i hulumtimeve, inovacioneve, zhvillimeve dhe punës që del nga industria. Për të identifikuar kërkesat e tregut të punës dhe kompetencat e të punësuarve që kërkon ai treg, duhet krijuar një mekanizëm që të përcjellë nevojat që kërkon ky treg, të dijë se si t'i interpretojë ato dhe se si t'i konvertojë në rezultate të pritshme në një program studimi apo trajnimi, si në aspektin e kompetencave që mund të arrijë një i diplomuar, ashtu edhe në atë të nivelit të programit që i përshtatet kërkesës.

II.1. Analiza e programeve të kërkuara në tregun e punës në Shqipëri

Për të analizuar ofertën akademike në tregun e punës në Shqipëri, grupi i punës i përbërë nga 5 lektorë të departamentit të Gjuhëve të Huaja, zhvilluan një sondazh me përfaqësues të bizneseve, të institucioneve të arsimit të lartë publik dhe privat në Shqipëri dhe me të diplomuar në IAL publike dhe jopublike.

Ky sondazh synon të nxjerrë në pah kompetencat e të diplomuarve dhe programet e studimit që i nevojiten sektorit publik dhe privat. Ekonomia shqiptare ka mungesë individësh të aftë për të plotësuar dhe për të drejtuar procesin e zhvillimit të sektorëve. Ndërkohë që ka shumë institucione të arsimit të lartë publik dhe privat që ofrojnë programe studimi të ngjashme në përmbajtje, është përqendrimi në aftësi, fusha, metodologjia e tansmetimit të informacionit dhe qasja e programeve studimore që e bëjnë programin njëkohësisht të ri dhe një përvojë të dobishme për studentët.

II.1.1 Metoda e Studimit

Rezultatet e këtij studimi u përdorën për të përcaktuar modulet e programit programit të trajnimit dhe kualifikimit, kërkesat e tregut, shkallën e interesit të studentëve dhe punëdhënësve për programet e studimit në UNIKO. Procedurat dhe metodat e rekomanduara për t'u përdorur në këtë studim janë si më poshtë:

1. Qasja kualitative dhe kuantitative si dhe nevojat e tregut për forma të tilla studimi;
2. Takime (takime të drejtpërdrejta / telefonata etj);
3. Vizitat në mjediset e biznesit, të institucioneve të tjera të arsimit të lartë etj.;



Më poshtë paraqiten disa nga fushat e rekomanduara për grupin kërkimor:

1. Struktura e studentëve, niveli i punësimit të të diplomuarve të UNIKO;
2. Bizneset e synuara ku studentët janë punësuar dhe të diplomuarit e punësuar në këto biznese;
3. Programet aktuale të studimit në vend dhe programet e kërkuara të trajnimit dhe kualifikimit;
4. Përfundime të bazuara në gjetjet nga të dhënat cilësore, industria, studentët dhe palët e tjera të interesit

II.1.2. Analiza e gjetjeve

II. 1.2.1. Gjetjet nga anketimi i bizneseve

Përputhshmëria e njohurive të fituara në studime me kërkesat e vendit të punës sipas sektorit ku operon biznesi



A mendoni se njohuritë e fituara nga i punësuari juaj gjatë studimeve janë ato që kërkohen për vendin e tij të punës?





Fig 1: Përputhshmëria e njohurive të fituara në studime me kërkesat e vendit të punës sipas sektorit ku operon biznesi


Rezultatet e pyetjes direkte për përceptimin e bizneseve në lidhje me përputhshmërinë e njohurive që të punësuarit i kanë fituar në studime me ato që kërkohen në vendin e tij/saj të punës, tregojnë se të anketuarit nga bizneset që operojnë në sektorët e prodhimit dhe tregtisë, kanë dhënë vlerësim më pozitiv në lidhje me nivelin e njohurive që të punësuarit e tyre kanë arritur gjatë studimeve. Sektori i shërbimeve duket se është më i pakënaquri me nivelin e njohurive që të punësuarit e tyre kanë arritur gjatë studimeve, me 68% të të anketuarve të cilët janë përgjigjur negativisht.

Përputhshmëria e aftësive të fituara në studime me kërkesat e vendit të punës sipas madhësisë së biznesit

Mikro biznes




Biznes i vogël



A mendoni se aftësitë (si p.sh., komunikimi, puna në grup, zgjidhja e problemeve, aftësia krijuese etj.) e fituara gjatë studimeve nga i punësuari juaj janë ato që duhen për vendin e tij/saj të punës?

Biznes i mesëm



Biznes i madh





Fig 2: Përputhshmëria e aftësive të fituara në studime me kërkesat e vendit të punës sipas madhësisë së biznesit

Rezultatet e pyetjes direkte për përceptimin e bizneseve mbi përputhshmërinë e aftësive që zotëron i punësuari me ato që janë të nevojshme për vendin e punës.


Duke ndjekur supozimin që bizneset me karakteristika të ndryshme kërkojnë aftësi të ndryshme, në këtë rast paraqitja grafike është ndarë sipas madhësisë së biznesit. Mikrobizneset me 1-4 punëtorë me 60.87% të tyre kanë dhënë mendim pozitiv në lidhje me shkallën e arritjeve të kompetencave specifike që të punësuarit e tyre kanë fituar gjatë studimeve. Të anketuarit e bizneseve/organizatave me numër më të madh të punësuarish kanë shprehur pakënaqësi më të madhe në lidhje me këto kompetenca të fituara nga të punësuarit e tyre. 65.22% e të anketuarve që kanë më shumë se 50 të punësuar, kanë dhënë mendimin se aftësitë e fituara gjatë studimeve nga punonjësit e tyre, nuk u përgjigjeshin kompetencave të nevojshme për vendin e tyre të punës.

Përputhshmëria e kompetencave të fituara në studime me kërkesat e vendit të punës sipas sektorit ku operon biznesi

Prodhim



Shërbime



A mendoni se aftësitë (si p.sh., komunikimi, puna në grup, zgjidhja e problemeve, aftësia krijuese etj.) e fituara gjatë studimeve nga i punësuari juaj janë ato që duhen për vendin e tij/saj të punës?



Fig 3: Përputhshmëria e kompetencave të fituara në studime me kërkesat e vendit të punës sipas sektorit ku operon biznesi

Rezultatet e pyetjes direkte për përceptimin e bizneseve në lidhje me përputhshmërinë e aftësive që i zotëron i punësuarit me ato që i nevojiten vendit të punës.

Duke ndjekur supozimin që bizneset me karakteristika të ndryshme kërkojnë aftësi të ndryshme në këtë rast paraqitja grafike është ndarë sipas sektorit ku operon biznesi. Sektori i shërbimeve është më i pakënaquri me kompetencat e fituara nga të punësuarit e tyre gjatë studimeve me 62% të të anketuarve të cilët kanë dhënë vlerësim negativ. Të anketuarit e sektorit të tregtisë janë më të kënaqur nga kompetencat e fituara nga të punësuarit e tyre gjatë studimeve; megjithatë 43.33% e tyre kanë dhënë mendim negativ për këto aftësi të fituara.

Përqindja bizneseve në vlerësimin e rëndësisë së kompetencave në shkallën nga 1-13 (1 më i rëndësishmi; 13 më pak i rëndësishëm)

Kompetenca	Mesatarja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
Komunikimi	5.3	28.6%	9.3%	4.5%	4.2%	8.0%	7.9%	1.9%		0.5%		0.5%	2.9%	24.8%
Prezantimi	5.4	3.6%	27.4%	10.7%	13.0%	8.5%	2.0%	1.4%		0.9%	0.5%	2.9%	24.3%	1.4%
Njohuri në edukim	8.3	6.5%	16.3%	15.9%	11.4%	13.5%	7.1%	4.8%	19.5%	5.0%	6.9%	7.9%	3.9%	2.4%
Njohuri pedagogjike dhe didaktike	8.1	20.4%	3.1%	50.5%	1.4%	1.4%	2.0%	1.0%	1.9%	3.6%	2.9%	3.4%	4.9%	0.8%
Zotërimi i gjuhës së huaj	5.6	3.2%	3.5%	37.5%	12.0%	9.4%	2.5%	1.4%	1.4%	0.9%	0.5%	23.5%	1.0%	3.8%
Numërimi	5.4	7.9%	10.8%	4.9%	31.5%	4.7%	6.9%		0.5%	2.3%	25.6%	2.0%	1.0%	1.0%
Shkrimi dhe leximi	4.9	17.5%	8.9%	4.0%	4.2%	30.0%	0.5%		1.0%	25.0%	1.0%	0.5%	0.5%	1.9%
Njohuri rreth teknologjisë së	8.8	25.1%	21.8%	18.6%	9.2%	6.6%	6.5%	4.2%	3.1%	2.4%	2.5%	1.3%	0.8%	0.4%

re														
Aftësi në përdorimin e teknologjisë	10.6	31.1%	22%	15.4%	18.3%	8.7%	9.2%	7.4%	7.7%	8.1%	4.0%	3.6%	2.3%	1.1%
Përdorimi i Kompjuterit	6.1	3.9%	4.6%	6.7%	1.9%	5.6%	44.8%	2.4%	25.7%	2.3%	1.0%	0.5%	0.5%	3.3%
Mendimi krijues	7.1	3.2%	2.3%	0.4%	0.9%	0.9%	2.0%	75.0%	6.2%	2.7%	1.9%	1.0%	4.9%	2.4%
Fleksibiliteti	7.3	2.5%	2.3%	0.9%	1.4%	0.5%	27.1%	4.8%	49.5%	5.0%	1.9%	2.9%	2.9%	2.4%
Mendim kritik	7.5	2.5%	1.2%	1.3%	0.9%	25.8%	3.0%	2.9%	4.8%	43.6%	9.7%	2.9%	1.9%	1.0%
Aftësitë analitike dhe sintetizuese	7.7	2.1%	2.3%	1.8%	25.9%	1.9%	1.0%	1.9%	2.4%	8.2%	44.4%	7.4%	1.5%	2.4%
Lidershipi	8.0	1.8%	2.3%	24.6%	2.3%	1.9%	0.5%	1.9%	4.3%	2.3%	5.3%	44.6%	10.2%	1.4%
Punë në ekip	8.1	2.9%	22.0%	1.8%	0.5%	1.4%		5.3%	2.4%	2.7%	5.3%	7.8%	43.7%	3.8%
Vendimmarrëse	8.5	20.4%	3.1%	0.9%	1.4%	1.4%	2.0%	1.0%	1.9%	3.6%	2.9%	3.4%	4.9%	50.5%

Fig

4:

Programet e kërkuara nga bizneset sipas fushave të veçuara për studim




Fig 5: Programet e kërkuara nga bizneset sipas fushave të veçuara për studim

Nga programet e veçuara në këtë studim, programet e studimit dhe trajnimit në teknologji, mjekësi dhe turizëm janë më të kërkuarat në tregun e punës nga punëdhënsit e sektorit privat

Programet e kërkuara nga sektori publik dhe OJQ-të sipas fushave të veçuara për studim





Fig 6: Programet e kërkuara nga sektori publik dhe OJQ-të sipas fushave të veçuara për studim


Në sektorin publik dhe OJQ ekziston një kërkesë më e ulët për programe të profilit administrativ, edukim dhe ekonomi, ndërsa për programet drejtësi, edukim dhe mjekësi dhe diplomaci edhe më tutje shprehet një interes më i lartë. Më të kërkuara për tregun e punës në sektorin publik mbeten programet në mjekësi, teknologji dhe sidomos teknologji digjitale.

Kompetencat më të rëndësishme sipas statusit ligjor të biznesit


Biznes Individual




Sh.P.K



Sh.A.



Institucion Publik







Fig 7: Kompetencat më të rëndësishme sipas statusit ligjor të biznesit

Sic mund shihet, bizneset e vlerësojnë përputhjen e kompetencave (të të dy llojeve – të përgjithshme dhe specifike) që të diplomuarit i arrijnë në përfundim të studimeve, me ato që kërkohen prej tyre në vendin e tyre të punës në nivel relativisht të ulët. Shumë ngjajshëm mendojnë edhe për nivelin e njohurive, shkathtësive/aftësive për performancën e tyre në punë. Në shkallën prej 1-5 me vetëm 2.7 janë vlerësuar këto dy variabla. Në të gjitha rastet, shkallën maksimale të vlerësimit e zë zotërimi i teknologjisë së re.

Nga grafiku shihen se institucionet publike dhe OJQ-të, megjithatë kanë një mendim më pozitiv në lidhje me përputhjen e kompetencave dhe nivelit të njohurive, shkathtësive/aftësive me kërkesat e tregut të punës për këto komponente për performancë të mirë në vendin e punës. Me mbi 3.0 vlerësohet nga këto dy lloje të institucioneve, përputhja e kompetencave gjenerike dhe specifike me kërkesat e tregut të punës. Në mënyrë të ngjashme është dhënë vlerësimi edhe për nivelin e njohurive dhe shkathtësive/aftësive. Një vlerësim mjaft të ulët për këto çështje japin bizneset individuale, një vlerësim që bie nën mesatarën e shkallës.

Kërkesa e bizneseve për nivel njohurish, aftësish/shkathtësish

Kërkesa juaj si punëdhënës për programet universitare (kurrikulat) është që kompetencat e arritura nga të diplomuarit të përmbajnë:



■ **Kërkesa juaj si punëdhënës për programet universitare (kurrikulat) është që kompetencat e arritura nga të diplomuarit të përmbajnë:**

Fig 8: Kërkesa e bizneseve për nivel njohurish, aftësish/shkathtësish

Mbi 70 % e bizneseve dhe institucioneve publike dhe OJQ-ve të anketuara janë të mendimit se universitetet me programet e tyre të studimit, për kompetenca të caktura, ju ofrojnë studentëve më shumë njohuri se sa shkathtësi/aftësi. Nga ana tjetër, rreth 71% e tyre mendojnë që në programet universitare duhet të ketë një shpërndarje të barabartë në ngarkesën e orëve mësimore mes njohurive dhe shkathtësive/aftësive.

Perceptimi i bizneseve lidhur me përputhshmërinë e programeve me nevojat e tregut të punës dhe vlerësimi për ndikimin e kompetencave në mundësinë e punësimit.




Fig 9: Perceptimi i bizneseve lidhur me përputhshmërinë e programeve me nevojat e tregut të punës dhe vlerësimi për ndikimin e kompetencave në mundësinë e punësimit.

Në perceptimet mesatare të dy variablave, treguesi në të majtë shënon ndikimin e hartimit të kompetencave në përputhje me nevojat e tregut në funksion të rritjes së normës së punësimit të të diplomuarve në programet universitare, ndërsa në të djathtë është mendimi i të anketuarve se aktualisht hartimi i kompetencave dhe i rezultateve të të nxënit është në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe në funksion të rritjes së normës së punësimit. Sa i përket variablës së parë vlerësimi mesatar i bizneseve është 4.27 në shkallë nga 1-5, pra ata janë të bindur se një hartim i përshtatshëm i kompetencave dhe rezultateve të të nxënit në një program studimi apo trajnimi, ka ndikim të madh në rritjen e normës së punësimit të të diplomuarve në programet universitare. Ndërsa, sa i përket variablës së dytë në një shkallë të njëjtë vlerësimi, vetëm vlerësimi mesatar është vetëm 2.86, pra mendimi i bizneseve është se aktualisht hartimi i kompetencave dhe rezultateve të të nxënit është pothuajse në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe në funksion të rritjes së normës së punësimit.

Njohja e kurrikulave nga bizneset në Shqipëri




Fig 10: Njohja e kurrikulave nga bizneset në Shqipëri

Në bazë të përgjigjeve të të anketuarve për njohjen e kurrikulave të IAL-ve, të gjitha bizneset dhe organizatat publike njohin mesatarisht përmbajtjen e programeve universitare në Shqipëri, por nga grafiku duket se organizatat me shërbime publike kanë njohuri më të madhe në lidhje me përmbajtjen e kurrikulave të programeve studimore, ku një numër më i madh i tyre kanë pohuar se i njohin shumë ose plotësisht.

Pjesëmarrja në diskutime të hartimit të kurrikulave sipas statusit ligjor të firmës

Sa herë merr pjesë organizata juaj në diskutime, propozime ose në hartimin e kurrikulave me ndonjë nga IAL-të në Shqipëri?




Fig 11: Pjesëmarrja në diskutime të hartimit të kurrikulave sipas statusit ligjor të firmës

Siç shihet edhe nga grafiku më lart, shumica e bizneseve/institucioneve publike ose OJQ-ve (afër 50%) të anketuara, kanë pohuar se nuk marrin pjesë asnjëherë në ndonjë formë bashkëpunimi me IAL-të, në hartimin e përbashkët të kurrikulave universitare. Pjesa tjetër e të anketuarve kanë deklaruar se bashkëpunojnë më rrallë se njëherë në tri vjet, e në veçanti bizneset individuale (afër 80% e tyre kanë dhënë një përgjigje të tillë).

Perceptimi i bizneseve mbi ndikimin e bashkëpunimit në rritjen e normës së punësimit dhe shkurtimit të periudhës tranzitore diplomim - punësim




Fig 12: Perceptimi i bizneseve për ndikimin e bashkëpunimit në rritjen e normës së punësimit dhe shkurtimit të periudhës tranzitore diplomim - punësim.

Në një shkallë vlerësim prej 1-5, ku 1 është “*aspak*”, ndërsa 5 është “*shumë*”, perceptimi mesatar i bizneseve, se bashkëpunimi mes IAL-ve dhe bizneseve ndikon në rritjen e normës së punësimit dhe në shkurtimin e periudhës tranzitore diplomim – punësim, është mbi 4. Vlerësimi për ndikimin e bashkëpunimit në shkurtimin e normës së punësimit është 4.21, ndërsa vlerësimi për shkurtimin e periudhës tranzitore është 4.25.

Studimi u ndal edhe në anketimin e IAL-ve publike dhe private dhe në anketimin e të diplomuarve në UNIKO mbi përputhjen e kompetencave të ofruara apo të fituara me nevojat dhe kërkesat e tregut.

Nga krahasimi i të dhënave u vu re:

Krahasimi deskriptiv i mostrave për variablat e përbashkëta

Kompetenca	Mesatarja		
	Biznese	IAL	Të diplomuar
	(n=220)	(n=59)	(n=263)
Komunikimi	4.277	4.203	4.236
Prezantimi	4.168	4.305	4.171
Zotërimi i gjuhës së huaj	4.082	4.017	4.103
Përdorimi i teknologjisë së re	4.211	4.223	4.203
Njohuri në edukim	3.982	4.002	4.012
Numërimi	4.014	4.136	4.148
Shkrimi dhe leximi	4.277	4.305	4.213
Përdorimi i Kompjuterit	4.155	4.203	3.878
Mendim krijues	3.882	3.898	3.970
Fleksibiliteti	3.886	3.780	3.966
Mendim kritik	3.832	3.864	3.916
Aftësitë analitike dhe sintetizuese	3.859	3.983	3.886
Lidershipi	3.682	3.864	3.916
Punë në ekip	4.109	4.220	3.981
Aftësi vendimmarrjeje	3.750	3.881	3.977

Dobishmëria për vendin e punës

Fig 13: Përceptimi i bizneseve për dobinë e kompetencave të përgjithshme krahasuar me përfshirjen e këtyre kompetencave në programe nga IAL-të dhe perceptimi për arritjen e tyre nga të diplomuarit.

Nga krahasimi i të dhënave, siç paraqitet dhe në tabelë, shihet se ekziston një perceptim i ngjajshëm i të tri grupeve të të anketuarve në lidhje me dobinë e këtyre kompetencave. Nga këto grupe, të gjitha kompetencat janë vlerësuar mbi mesataren, bazuar në shkallën e dhënë në pyetësor. Të gjitha janë vlerësuar me mbi “deri diku” dhe shumë prej tyre me “shumë”.

“Komunikimi”. “Përdorimi i teknologjisë së re” dhe “Shkrim leximi” janë kompetencat e përgjithshme më të vlerësuara nga të gjitha grupet, ku në shkallën 1 – 5, janë vlerësuar me mbi 4.2. “Mendimi krijues” dhe “Njohuri në edukim” janë vlerësuar gjithashtu me një shkallë të lartë.

Nga tabela vërehet se kompetencat si “Komunikimi”, “Përdorimi i teknologjisë së re”, “Zotërimi i gjuhës së huaja” dhe “Fleksibiliteti” janë të vlerësuar më shumë nga bizneset, se sa përceptohet përfshirja e tyre në programe nga ana e IAL-ve.

Vlerësimi i bizneseve për përputhjen mes asaj që ka arritur të përvetësojë i diplomuari në IAL dhe asaj që i kërkohet të bëjë në punë krahasuar me përceptimin e IAL-ve dhe të diplomuarve për të njejtën gjë.

Kompetenca	Mesatarja		
	Biznese (n=220)	IAL (n=59)	Të diplomuar (n=263)
Komunikimi	2.745	3.475	3.806
Prezantimi	2.732	3.610	3.778
Zotërimi i gjuhës së huaj	2.750	3.305	3.278
Përdorimi i teknologjisë së re	2.658	3.461	3.534
Njohuri në edukim	2.805	3.567	3.781
Numërimi	2.668	3.288	3.861
Shkrimi dhe leximi	2.936	3.610	3.778
Përdorimi i Kompjuterit	2.805	3.627	3.861
Mendim krijues	2.532	3.186	3.722
Fleksibiliteti	2.555	3.271	3.694
Mendim kritik	2.500	3.153	3.722
Aftësitë analitike dhe sintetizuese	2.518	3.254	3.556
Lidershipi	2.532	3.203	3.778
Punë në ekip	2.695	3.559	4.028
Aftësi vendimmarrjeje	2.518	3.271	4.056

Fig 14. Përputhja e kompetencave me kërkesat e vendit të punës

Vlerësimi i bizneseve për përputhjen mes asaj që ka arritur të përvetësojë i diplomuari në IAL dhe asaj që i kërkohet të bëjë në punë krahasuar me përceptimin e IAL-ve dhe të diplomuarve për të njejtën gjë.

Kompetenca	Mesatarja		
	Biznese (n=220)	Universitete (n=59)	Të diplomuarit (n=263)
Prodhim/Operacione	2.595	4.500	3.167
Sjellje organizative/Zhvillim/ Ndryshim	2.641	4.551	3.800
Marketing	2.623	4.520	3.633

Shitje	2.695	4.500	3.733
Financa	2.632	4.471	3.767
Kontabilitet	2.632	4.500	3.500
Ekonomi	2.632	4.520	3.700
Teknologji	2.771	4.231	3.534
Burime njerëzore	2.632	4.420	3.333
Biznes ndërkombëtar	2.536	4.346	2.633
Strategji	2.536	4.472	3.300
Sipërmarrje	2.623	4.437	3.333
Edukim	2.541	4.543	3.765
Drejtësi	2.609	4.469	3.433
Disiplina të ngjashme (psh. (psh. Administrim, Sociologji, Psikologji)	2.686	4.437	2.900

Fig 15. Përputhja e kompetencave specifike me kërkesat e vendit të punës

Edhe për kompetenca specifike ekziston një mospërputhje e qartë në vlerësimin e bizneseve për përputhjen mes asaj që ka arritur të përvetësojë i diplomuari në IAL dhe asaj se që i kërkohet të bëjë në punë krahasuar me perceptimin e IAL-ve dhe të tëdiplomuarve për të njejtën gjë. Të vogël deri në neutral e konsiderojnë bizneset përputhjen e këtyre kompetencave meatë që kërkohet nga të punësuarit në vendin e punës. Në shkallën 1-5, afërsisht 2.6 është vlerësimi bizneseve. Më të kënaqur me këtë përputhje janë IAL-të dhe të diplomuarit dhe në veçanti IAL të cilat japin vlerësim gati maksimal, në shkallën mbi 4.5 me maksimum 5.

KREU III

MASAT E MARRA PËR TË RRRITUR CILËSINË DHE KOMPETENCAT E TË DIPLOMUARVE DHE TË TË PUNËSUARVE NË PËRPUTHJE ME NEVOJAT DHE KËRKESAT E TREGUT

Studimi i tregut që u hartua gjatë periudhës së parë të zbatimit të projektit, nxorri në pah se ka shumë pak të diplomuar në fusha që rezultojnë mjaft të kërkuara, si p.sh. për specialistë të TI, analistë, programues, teknologë, kontabilistë, menaxherë prodhimi, inxhinierë tekstilësh, inxhinierë mekanikë. Përveç kësaj, programet universitare janë kryesisht teorike dhe kanë mangësi përsa i përket aftësisë praktik. Po kështu, ka një numër të madh të diplomuarish në degë të tilla, si p.sh. në edukim, administrim biznesi, financë, gjuhë angleze, histori dhe gjeografi. Ky rezultat çon te deformimi i tregut të punës, te mungesa e ofertës së punës, ndërkohë që ka kërkesë për punë dhe mbiofertë të punës në fusha të tjera për të cilat ka më pak kërkesë.

Nga ana tjetër, Qendrat Universitare të Formimit të Vazhduar (QFV) merren kryesisht me trajnimin e mësuesve në detyrë, duke lënë mënjanë nevojën e kualifikimit për grupe të tjera interesi, si maturanët në dhënien e provimeve të gjuhëve të huaja, apo anëtarë të tjerë të komunitetit që duan të mbrojnë gjuhën e huaj në një nga provimet ndërkombëtare. Oferta e trajnimit është e dobët përsa i përket numrit të kurseve të ofruara në teknologjinë digjitale: kurset e lidhura me përdorimin e teknologjisë janë të shkurtra, programet janë të vjetëruara dhe me mangësi (mungesa e materialeve mësimore), si dhe cilësia e instruktorëve është e ulët. Nuk ka asnjë lloj lidhjeje midis QFP-ve (Qendrave të Formimit Profesional) dhe bizneseve, për sa u përket trajnimit me module të teknologjisë digjitale, si edhe mungon një sistem, i cili do të gjurmonte suksesin e të diplomurve në tregun e punës.

Po kështu, “Raporti i rregullt i Bankës Botërore për Ballkanin Perëndimor”², në vlerësimin e ndikimit të COVID-19 mbi arsimin dhe kundërpërgjigjen e vendeve nxjerr në pah se përmirësimi dhe shkallëzimi i politikave në përgjigje të COVID-19, përfshirë uljen e ndarjes digjitale dhe përfitim të aftësive digjitale të mësuesve, do të sillnin qëndrueshmëri të sistemit ndaj goditjeve të ardhshme. Për të kapërcyer vështirësitë e paraqitura nga kjo situatë nevojiten disa parakushte, të tilla si: (1) mundësia e përdorimit dhe lidhja me TIK-un, (2) disponueshmëria e përmbajtjes cilësore online, (3) mësues të aftë për mësimdhënie në distancë dhe online, (4) mbështetja e prindërve për mësimdhënien në distancë dhe online, si dhe (5) koha e mjaftueshme për mësimdhënie.³

² Raporti i rregullt ekonomik për Ballkanin Perëndimor Vlerësim i ndikimit të COVID-19 mbi arsimin dhe kundërpërgjigjia e vendeve, Banka Botërore (2020)

<http://pubdocs.worldbank.org/en/550271590827524462/RER-Education-COVID-ALB.pdf>

³ Ofrimi i programeve të studimit dhe trajnimit për të përmbushur më mirë nevojat ekonomike dhe të tregut të punës (duke ju siguruar të diplomuarve aftësi përkatëse në tregun e punës), Raporti i rregullt ekonomik për Ballkanin Perëndimor Vlerësim i ndikimit të COVID-19 mbi arsimin dhe kundërpërgjigjia e vendeve, Banka Botërore (2020)

<http://pubdocs.worldbank.org/en/550271590827524462/RER-Education-COVID-ALB.pdf>

Ndonëse nuk ka të dhëna ndërshtetërore, ka tregues të qartë⁴ që mësuesit në Ballkanin Perëndimor nuk janë të përgatitur për të mbështetur të nxënit efektiv online për shumë kohë. Të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor e pranojnë rëndësinë e aftësive digjitale, ndonëse kanë përqafuar qasje të ndryshme për zhvillimin e këtyre aftësive ndërmjet mësuesve.

Rimodelimi i Laboratorit të gjuhëve të huaja dhe shndërrimi i tij në një mjedis virtual të të nxënit do të krijojë një mundësi për të kapërcyer këto vështirësi dhe për të mbyllur hendekun digjital për mësuesit e gjuhëve duke ndërtuar kështu më shumë fleksibilitet të sistemit për t'u përshatur ndaj rrethanave dhe për t'u përballur me situata të ngjashme.

III.1. Identifikimi qendrave të ngjashme dhe vlerësimi i nevojave në fushën e edukimit digjital

I gjithë stafi i departamentit të gjuhëve të huaja u përfshi në veprimtaritë e parashikuara të kësaj pakete pune. Hulumtimi në terren dhe kërkimi në tavolinë ishin dy hapat kryesorë që mbështetën metodologjinë e punës. Instrumentet e përdorura për vjeljen e të dhënave mbi gjurmimin e programeve dhe kurseve të ngjashme ishin formularët e punuar në formatin excel

(Shiko:

https://docs.google.com/spreadsheets/d/1AFx8LkSB_OuziOXbLNbEëc5RZaYDXf6Hy/edit#gid=277544755

[https://docs.google.com/spreadsheets/d/19YxJALEnDkHJ7-OjaMBFX4X-](https://docs.google.com/spreadsheets/d/19YxJALEnDkHJ7-OjaMBFX4X-bNq_8xug/edit#gid=637916652)

[bNq_8xug/edit#gid=637916652](https://docs.google.com/spreadsheets/d/19YxJALEnDkHJ7-OjaMBFX4X-bNq_8xug/edit#gid=637916652)) Për identifikimin e nevojave të palëve të interesit u përdorën pyetësorë me studentët, stafin akademik të UNIKO, institucionet vendore dhe institucionet arsimore të rajonit të Korçës. Pyetësorët u hartuan në formatin Google form

(Shiko: https://docs.google.com/forms/d/1EëzkgHëëEqc9yg2NjSN3CNTfH_i1Lt3QRv1vEuNrTX4/edit

https://docs.google.com/forms/d/1a0mg1nO5dCQVKR6Y3jJ4ji2EëB_mHEQgJqNëhEXE_CX8/edit

https://docs.google.com/forms/d/1yfFMudOhMPëUxOOESr-5yt8T7RRUvSzrbRCKi_lePe8/edit

<https://docs.google.com/forms/d/1ëëfCtC4qgHzRYFQIIHTusXaSck9ms8jLpTO3FhTpKuk/edit>)

Raporti përfundimtar analizon kurrikulat e ngjashme për arsimin digjital në Ballkan dhe Evropë për të identifikuar mangësitë dhe për të vlerësuar nevojat akademike që duhen përballuar nga projekti DigjKomp për Departamentin e Gjuhëve të Huaja, UNIKO. Temat e

⁴ “Në udhëzimet e saj politike, Presidentja von der Leyen theksoi nevojën për të zhbllokuar potencialin e teknologjive digjitale në procesin e mësimdhënies dhe nxënies me qëllim zhvillimin e aftësive digjitale për të gjithë”, *Edukimi digjital, Plani i veprimit 2021 - 2027*, Këshilli i Evropës, https://ec.europa.eu/education/sites/education/files/document-library-docs/deap-communicationsept2020_en.pdf

hulumtuara në këtë veprimtari të parë të paketës së parë të punës të projektit janë si më poshtë:

- Identifikimi dhe analiza e programeve të ngjashme të trajnimit në Labororët/Departamentet e Gjuhëve të Huaja Shqipe.
- Përvijimi dhe analiza e literaturës gri mbi edukimin dixhital.
- Identifikimi i nevojës për një program LLL në arsimin dixhital që do të ofrohet nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja, UNIKO.

Gjetjet dhe analiza SWOT janë përmbledhur në një dokument të hartuar në gjuhën angleze për shkak se do të bëhet publik në një veprimtari ndërkombëtare që Departamenti i Gjuhëve të huaja do të organizojë në datat 10-11 qershor 2022. (Shiko: https://drive.google.com/drive/u/0/folders/1uIScALBPLLBSla_xDkHv2Dd4MXpoMmT)

Nga analiza e programeve të ngjashme të cilat synonin grupin e mësuesve të gjuhëve të huaja dhe zhvillimin e aftësive të tyre digjitale në mësimdhënie, u identifikuan institucione arsimore të cilat ose ofronin module të ngjashme trajnimi ose kishin hartuar strategji për plotësimin e këtyre nevojave. Në këtë kuadër UNIKO ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucionet e mëposhtme:

- Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”
- Universiteti “Fehmi Agani”, Gjakovë, Kosovë
- Technical University of Cluj-Napoca, Romania.

III.2. Hartimi i programit të trajnimit dhe kualifikimit

Pas përfundimit të veprimtarive të realizuara në paketën e parë të punës me identifikimin e nevojave për module trajnimi në fushën e edukimit digjital, u pa e nevojshme që stafi i cili do të hartojë këto module duhej të trajnohej në lidhje me krijimin dhe shpërndarjen e tyre. Janë pajisur kompjuterat e laboratorit të gjuhëve të huaja me programe të reja dhe janë blerë nga fonde të dyta (jo nga buxheti i alokuar nga agjencia financuese) suport pedagogjik për mesimdhënie dhe ushëra. Mbështetje financiare për rritjen e kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturore të departamentit të Gjuhëve të Huaja është dhënë nga Agjencia Universitare e Frankofonisë (AUF).

Duke ndjekur ecurinë e rezultateve të PP1, u vu re se ndërtimi i kapaciteteve njerëzore në DGJH përmes zhvillimit profesional të stafit akademik, teknik dhe administrative ishte e domosdoshme të realizohej para ndërtimit dhe hartimit të moduleve të trajnimit dhe kualifikimit. Mundësitë e zhvillimit profesional shpesh janë të kufizuara në institucionet e arsimit të lartë dhe përmes këtij projekti, stafit do t'i jepej mundësia të përballej me praktikant më të mira të vendeve të ndryshme. Për këtë arsye një nga rezultatet e pritshme të kësaj veprimtarie është përmbushur me dy trajnime të zhvilluara nga një përfaqësues i Alenacën Franceze në Tiranë dhe një përfaqësues i AUF (Gjeorgji) mbi modelet dhe platformat digjitale të përdorura në mësimdhënien e gjuhës së huaj.

<https://drive.google.com/file/d/1V5ëSDnëMHD6X4bitQpY9EC-OyF8ALd59/vieë?usp=sharing>) Trajnimi 2: (https://drive.google.com/file/d/1dIX-NyH3gxmPo-rqCz3ëUI0X_nV0pTIX/vieë?usp=sharing)

Masa e pare, pra hartimi i programit të trajnimit dhe kualifikimit, ishte strukturore dhe përfshiu krijimin dhe zbatimin e një kornize referimi të aftësive digjitale për çdo nivel të sistemit arsimor në Shqipëri. Korniza u hartua në bashkëpunim me mësuesit në detyrë dhe DRAP Korçë, duke përdorur një qasje të qëndrueshme në mënyrë që të jetë e zbatueshme si për teknologjitë e sotme, ashtu edhe për ato të së nesërme.

Kuadri do të sigurojë një kuptim më të mirë të aftësive digjitale dhe do të ndihmojë të gjithë studentët, mësuesit në detyrë dhe specialistët e fushës së edukimit të zhvillojnë këto aftësi. Ai do të bëhet një mjet referimi për planifikimin pedagogjik dhe strategjik, si dhe për projektet lëndore. Në projektpropozimin fillestar ishte parashikuar hartimi i programit me bazë 5 module trajnimi dhe kualifikimi. Nisur nga interesi dhe shtrirja shumë e gjerë e mjeteve digjitale të përdorura në mësimdhënien e gjuhëve të huaja dhe jo vetëm , stafi propozoi 10 module trajnimi të cilat do të ofroheshin për trajnim pa ndryshim në buxhetin e projektit. Programi i trajnimit dhe kualifikimit:

(Shiko:

<https://drive.google.com/file/d/1BKc7yuvHNIhXj8K0Etb7ksËPCMrO5ëV/vieë?usp=sharing>)

Hartimi i rregullores së programit të

(Shiko: <https://drive.google.com/file/d/16c756eAODd7z8SboQQkmK0FC41hn5-Qq/vieë?usp=sharing>)

Raporti përfundimtar mbi modulet e ofruara, procedura dhe përmbajtja e programit të trajnimit pasqyrohen në raportin përfundimtar të kësaj pakete pune. Raporti përfundimtar dhe rekomandime

(https://drive.google.com/file/d/1PQ8qDa_c_8dYkrbAG5lqFoHM7ëëCvRdd/vieë?usp=sharing)

III.2.1. Krijimi i Qendrës së gjuhëve të huaja si mjedis virtual i të nxënësve

Mjedisi virtual i të nxënësve është konceptuar i ndarë në tri hapësira:

1. **Hapësira akademike:** Kjo hapësirë është projektuar për stafin akademik, për të rritur aftësitë e tyre mësimdhënëse duke i njohur dhe trajnuar me praktikat më të mira në fushën e edukimit digjital për programe shtesë specifike. Ky trajnim u realizua nga ekspertët IT të UNIKO. (Shiko: <https://www.facebook.com/unkorce/posts/pfbid0u9GV4kqYid5M6eQLqdPhëhsB7bfaimazGfPeoBduGCËTVfVëksQ3RV4VëuZx8Zdgl>)



<https://unkorce.edu.al/perdorimi-i-platformave-digjitale-ne-procesin-mesimor-ishtegjellimi-i-trajnimet-ge-stafi-it-i-universitetit-fan-s-noli-zhvilloi-me-pedagoge-te-departmentit-te-gjuheve-te-huaja/>

2. **Biblioteka Virtuale:** Kjo hapësirë është projektuar për të gjithë grupet e interesit në programin e trajnimit dhe kualifikimit. Kjo do të jetë një hapësirë virtuale, e aksesueshme për të gjithë, me materialet përkatëse për modulet e ofruara. Ajo përfshin planprograme të moduleve, libra shkollorë, artikuj revistash, dokumente politikash, prezantime konferencash, materiale video dhe audio, harta, imazhe, lidhje me revista dhe platforma të tjera të ngjashme. Pasurimi i kësaj biblioteke virtuale u mundësua edhe me blerjen e metodave dhe licenses numerike Cosmopolite

<https://drive.google.com/file/d/1fPhqZ18ZJGUK8jonyg4QOT6RjIIIX807/view?usp=sharing>

Kjo bibliotekë do të shërbejë si një portal bashkëpunimi dhe mbështetjeje gjatë ofrimit të shërbimeve të qendrës.

3. **Modulet e trajnimit:** Kjo hapësirë u projektua për përfaqësuesit nga sektorët e lidhur me arsimin, si dhe për këdo që dëshiron të mësojë se si të adresojë sfidat e reja të paraqitura nga globalizimi në lidhje me sigurimin e dhe ofrimin e shërbimeve. U krijuan 10 module trajnimi, të përshtatura për nevojat e trajnimit të institucioneve rajonale të lidhura me edukimin. Udhërrëfyesi i trajnimit është dokument shoqërues i kësaj hapësire.

(Shiko:

<https://drive.google.com/file/d/1BKc7yuvHNlhXj8K0Etb7ksËPCMrO5ëV/view?usp=sharing>)

III.3. Organizimi i kurseve të trajnimit dhe kualifikimit

Kjo veprimtari filloi sipas një kalendari të miratuar në departament.

(Shiko:

<https://drive.google.com/file/d/1pOzj-Ots54DjKkaODNPFFGjXFpqXzAmo/view?usp=sharing>)

Për secilin modul të ofruar janë bërë njoftimet tek institucionet e arsimit parauniversitar, në bashkëpunim me DRAP Korçë. Njoftime janë përcjellë edhe në faqen zyrtare të UNIKO dhe në rrjetet sociale.

(<https://www.facebook.com/photo?fbid=639011058232827&set=a.520530603414207>)

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=707228868077712&set=a.520530603414207>

Dokumentimi i moduleve të zhvilluara është bërë në faqen e Departamentit të Gjuhëve të Huaja

<https://www.facebook.com/search/top?q=departamenti%20i%20gjuh%C3%ABve%20%C3%A%20huaja%20%C3%A%20universiteti%20%27%27fan%20s>

https://m.facebook.com/story.php?story_fbid=634695445342863&id=100064072388621&mibextid=Nif5oz

<https://ëëë.facebook.com/photo/?fbid=701356461998286&set=pcb.701356538664945>

<https://ëëë.facebook.com/100063830850498/posts/675802677890755/?mibextid=Nif5oZ>

https://m.facebook.com/story.php?story_fbid=663482305789459&id=100063830850498&mibextid=Nif5oz

<https://ëëë.facebook.com/100063830850498/posts/661615312642825/?mibextid=Nif5oZ>

https://m.facebook.com/story.php?story_fbid=656897186447971&id=100063830850498&mibextid=Nif5oz
<https://www.facebook.com/100063830850498/posts/642451174559239/?mibextid=Nif5oz>
<https://www.facebook.com/photo/?fbid=641020208031912&set=pcb.641020814698518>
<https://www.facebook.com/photo/?fbid=635274345273165&set=pcb.635274655273134>


Çdo trajnim u shoqërua me certifikimin e pjesëmarrësve dhe vlerësimin me kredit/e të modulit të ofruar. Certifikimi u bë mbështetur në modelin e certifikatës:
<https://drive.google.com/file/d/11PkuHsU7JCpklGYxzRkNyU6IRIEkoq5f/view?usp=sharing>

III.4. Organizimi i simpoziumit shkencor

Arritjet dyvjeçare të projektit u përmbledhën në simpoziumin shkencor “Edukimi digjital – nevoja dhe zbatime” në të cilin morën pjesë stafi i departamentit të Gjuhëve të Huaja, mësues në detyrë, studentë të ciklit Master në “Mësues i gjuhës angleze” të diplomuar dhe grupe të tjera interesi.

<https://www.youtube.com/watch?fbclid=IëAR2ehDXk3xmhGqQfgObkSDxHvaHVeXFD0MUocHazv8nlgOvM4rXysb6TËi8&v=8XHzb9EI9qI&feature=youtu.be>

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=728960189241670&set=pcb.728966642574358>



Fisha praktike dhe diskutime të zhvilluara gjatë Simpoziumit janë përmbledhur në botimin online të librit të bardhë: “Edukimi digjital – nevoja dhe zbatime”.

<https://digicompwhitebook.tiiny.site/>

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Përfundimet e projektit për shndërrimin e laboratorit të gjuhëve të huaja në një mjedis virtual të nxëni dhe ofrimin e trajnimeve për mësuesit në detyrë, specialistët e zyrave arsimore dhe studentët e programeve të mësuesisë me kompetencën digjitale e vendosin theksin në:

1. Krijimin e mjedisit virtual për mësimin e gjuhëve të huaja:

- Projekti ka mundësuar shndërrimin e laboratorit të gjuhëve të huaja në një mjedis virtual të cilin nxënësit mund ta përdorin për të praktikuar gjuhën në mënyrë interaktive dhe të përmirësojnë aftësitë e tyre komunikuese.

2. Përmirësimin e aftësive të nxënësve:

- Përfundimet tregojnë se përdorimi i mjedisit virtual shfaq rezultate në përmirësimin e aftësive gjuhësore të nxënësve duke iu mundësuar të përfshihen në aktivitete të shumta dhe të larmishme.

3. Sukses në përdorimin e teknologjisë për mësimin:

- Feedback-u i vjelë nga mësuesit dhe të diplomuarit në programin “Mësues i gjuhës angleze” tregon për arritje në përdorimin e teknologjisë për të krijuar një mjedis të pasur dhe inovativ për mësimin e gjuhëve të huaja, duke bërë mësimdhënien më tërheqëse dhe efektive.

4. Trajnime efektive për mësuesit në detyrë dhe specialistët e zyrave arsimore:

- Përfundimet tregojnë se trajnimet për mësuesit në detyrë dhe specialistët e zyrave arsimore kanë qenë efektive në përmirësimin e aftësive digjitale dhe në aftësimin e tyre për të përdorur dhe menaxhuar platformat virtuale.

5. Ndikim pozitiv në procesin e mësimdhënies dhe të nxënit:

- Diskutimet e zhvilluara me mësuesit e trajnuar të pranishëm në simpoziumin e mbajtur në përfundim të projektit kanë nxjerrë në pah ndikimin pozitiv të trajnimeve në procesin e mësimdhënies dhe nxënit duke përdorur teknologjinë dhe mjetet digjitale për të përmirësuar përfshirjen, angazhimin dhe rezultatet e nxënësve.

6. Rritja e nivelit të motivimit:

- Niveli i motivimit të të trajnuarve është rritur ndjeshëm me vullnetin për të përfshirë elementë interaktivë dhe sfida të personalizuar në mjedisin virtual.

7. Ndhurma në forcimin e kapaciteteve të mësuesve dhe specialistëve të zyrave arsimore:

- Projekti ka ofruar një kontribut të rëndësishëm në forcimin e kapaciteteve të mësuesve dhe specialistëve të zyrave arsimore në fushën e teknologjisë edukative dhe përdorimit të mjedisve virtualë.

8. Përshtatja me mjedisin e ndryshueshëm arsimor:

- Përfundimet e projektit theksojnë nevojën e mësuesve për t'ju përshtatur mjedisit virtual në situata të ndryshueshme, duke pasuar një kornizë që mund të përshtatet me zhvillimet e ardhshme dhe sfidat në arsim.

9. Nevoja për vazhdimin e trajnimeve dhe përditësimit të Programit të trajnimit dhe kualifikimit:

- Përfundimet sjellin në vëmendje nevojën për vazhdimin e trajnimeve dhe përditësimin e Programit të trajnimit dhe kualifikimit për të ruajtur një nivel të lartë cilësie dhe përshtatshmërie me zhvillimet e reja teknologjike.

Përmes këtyre përfundimeve, është e qartë se projekti ka sjellë ndryshime pozitive dhe ka kontribuar në përmirësimin e përvojës së arsimit në fushën e gjuhëve të huaja dhe kompetencës digjitale për të gjithë pjesëmarrësit.

REKOMANDIME

Me qëllim krijimin e një mjedisi të përshtatshëm dhe inkurajues për përdorimin e teknologjisë në arsim, përmes gjetjeve të këtij studimi rekomandohet:

Për mësuesit në detyrë:

1. Të krijohen materiale dhe burime të qasshme:

- Drejtoria e shkollës, zyrat arsimore vendore duhet të krijojnë kushtet që mësuesit të kenë qasje të lehtë në materiale dhe burime të përdorshme në mësimdhënie, duke përfshirë softuerë, aplikacione edukative, dhe video-materiale të këndshme për nxënësit.

2. Të ofrohen ndihmë teknike dhe trajnime efektive:

- Mësuesve duhet t'u ofrohet ndihmë teknike për të lehtësuar përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie.
- Të zhvillohen trajnime efektive që përputhen me nevojat e tyre të mësimdhënies dhe që përfshijnë përdorime praktike. Trajnimet nuk duhet të kufizohen vetëm në përpjekjet vetjake të mësuesve në kuadër të zhvillimit profesional, por duhet të angazhohen edhe rrjetet profesionale me tematika praktike, të kohës dhe me interes për mësuesit.

3. Platforma gjithëpërfshirëse dhe interaktive:

- Të përdoren platforma që nxitin bashkëveprimin dhe pjesëmarrjen e nxënësve.

- Të përdoret teknologjia për të përmirësuar diversitetin dhe përfshirjen në mësimdhënie.

Për studentët e programeve të mësuesisë:

1. Zhvillimi i aftësive bazë teknologjike:

- Merrni pjesë në trajnime dhe seminare që ofrohen nga institucionet e arsimit të lartë dhe organizatat profesionale për të zhvilluar aftësitë bazë teknologjike.

2. Eksperimentimi me softuerët edukativë:

- Provoni dhe eksperimentoni me softuerë edukativë të ndryshëm që mund t'ju ndihmojnë në zhvillimin e materialeve mësimore dhe përmirësimin e përvojës së mësimit.

3. Përdorimi i platformave të krijuara për qëllime edukimi:

- Përdorni platforma dhe mjedise online të krijuara posaçërisht për edukimin dhe mësimdhënie virtuale.
- Eksploroni mundësitë për zhvillimin e resurseve interaktive dhe materialeve të përshtatshme për nxënësit.

4. Pjesëmarrja në komunitete dhe grupet e diskutimit:

- Bashkohuni në komunitete online dhe grupet e diskutimit për mesues, ku mund të ndani ide dhe përvoja me kolegët tuaj të tjerë dhe të merrni këshilla dhe sugjerime.

5. Ndihma nga platforma e lëndës:

- Përdorni platformat dhe burimet e lëndës që ofrohen nga institucionet arsimore për të përmirësuar njohuritë tuaja në fushën e teknologjisë edukative.

6. Zbulimi i mjeteve për krijimin e multimedia-s:

- Zhvilloni aftësi në përdorimin e mjeteve të krijimit të multimedia-s, si video, animacione, dhe prezentime të tjera, për ta bërë më tërheqëse dhe efektive mësimdhënien.

7. Thellimi i njohurive në lidhje me metodologjitë e mësimit online:

- Kuptoni metodologjitë dhe strategjitë e mësimit online dhe praktikoni përdorimin e tyre në mjedisin e mësimit.

8. Përfshirja në projekte inovative:

- Merrni pjesë në projekte inovative që integrojnë teknologjinë në mësimdhënie dhe metodat e reja mësimore.

9. Rrjetet sociale dhe blogjet edukative:

- Krijoni ose bashkohuni në rrjete sociale dhe blogje edukative për të ndarë përvojat tuaja, si dhe për të lexuar dhe mësuar nga përvojat e kolegëve tuaj.

10. Përgatitja për kërkesat e tregut të punës:

- Kuptoni se sektori i arsimit po ndryshon dhe njohuritë në teknologji janë një avantazh konkurrues në tregun e punës. Përgatituni për këtë ndryshim duke përdorur dhe zhvilluar aftësitë tuaja digjitale.

Përmes këtyre praktikave, studentët e fushës së mesuesisë mund të përgatiten më mirë për të përdorur teknologjinë në mësimdhënie dhe të bëhen mesues të suksesshëm në shoqërinë digjitale.

Për politikëbërësit:

1. Investime në infrastrukturën teknologjike:

- Krijoni dhe ndihmoni infrastrukturën teknologjike në shkolla dhe institucionet e arsimit për të siguruar një ambient të përshtatshëm për mësim online dhe për të përmirësuar kompetencën digjitale.

2. Politika për përdorimin e teknologjisë:

- Krijoni politika që inkurajojnë përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie, duke përfshirë trajnime për mesuesit dhe sigurimin e burimeve teknologjike.

3. Shkëmbimi i informacionit dhe bashkëpunimi rajonal:

- Ndani praktika të mira dhe përvoja me institucionet dhe vendet tjera për të forcuar bashkëpunimin dhe shkëmbimin e njohurive.

4. Sigurimi i aksesit në internet:

- Ndërmerrni hapa për të siguruar aksesin e përgjithshëm në internet për të gjithë nxënësit dhe mesuesit, përfshirë edhe ato komunitete që mund të jenë në zona me vështirësi të aksesit.

5. Mbështetje financiare dhe incentiva:

- Ofroni ndihmë financiare dhe incentiva për shkollat dhe mesuesit që janë të angazhuar në përdorimin e teknologjisë për të përmirësuar mësimdhënien dhe kompetencën digjitale.

LITERATURA

Arulampalam, W., Booth, A. L., dhe Taylor, M. P. (2000). Unemployment persistence. *Oxford Economic Papers* (Vazhdimësia e papunësisë. Dokumentet Ekonomike të Oksfordit), 52(1):24–50.

Arulampalam, W., Gregg, P., dhe Gregory, M. (2001). Unemployment scarring. *Economic Journal* (Ndikimet negative afatgjata të papunësisë. Buletini Ekonomik), 111(475):F577–584.

Braga, Michela (2009). When the Manna Comes from Abroad - Remittances and Youth Labor Market Behavior in Albania. Paolo Baffi Centre Research Paper No. 2009- 41 (Kur Zgjidhja vjen nga jashtë vendit- Remitancat dhe Sjellja e Tregut të Punës të Rinjve në Shqipëri. Dokument Kërkimor i Qendrës Paolo Baffi Nr. 2009-41).

Gangl, M. (2003). Welfare states and the scar effects of unemployment: A comparative analysis of the United States and West Germany. (Shtetet e mirëqenies dhe ndikimet negative afatgjata të papunësisë: Analizë krahasuese e Shteteve të Bashkuara dhe Gjermanisë Perëndimore. Buletini Amerikan i Sociologjisë, 109:1319-64)

Gesano, G., Heins, F., dhe Naldini (2009). A. Regional Challenges in the perspective of 2020, Regional disparities and future challenges. Background paper on Demographic Challenge. ISMERI Europa. (Sfidat Rajonale në perspektivë për vitin 2010. Pabarazitë rajonale dhe sfidat e ardhshme. Dokument me informacion paraprak mbi Sfidën Demografike. ISMERI Europa)

http://ec.europa.eu/regional_policy/sources/docgener/studies/pdf/challenges2020/regional_challenges_demographic_challenge.pdf

ILO dhe INSTAT (2012). “Working children in the Republic of Albania - The results of the 2010 National Child Labour Survey”. International Labour Organization, International Programme on the Elimination of Child Labour (IPEC), Institute of Statistics (INSTAT) of the Republic of Albania. (“Fëmijët që punojnë në Republikën e Shqipërisë Rezultatet e Vrojtimit Kombëtar të Punës së Fëmijëve të vitit 2010”. -Budapest: ILO, 2012).

Zyra Ndërkombëtare e Punës (2002). Decent Work and the Informal Economy: Sixth Item on the Agenda. (Puna e Denjë dhe Ekonomia Informale: Pika e Gjashtë e Axhendës) Gjenevë, ILO.

Mehran, F. (2013), “Technical note” on “Data on economic characteristics” (“Notë shpjeguese” mbi “Të Dhënat për karakteristikat ekonomike”) Tirana: INSTAT.

Mundaca, B. G. (2009). Remittances, financial market development, and economic growth: the case of Latin America and the Caribbean. *Review of Development Economics*, 13(2), 288-303 (Remitancat, zhvillimi i tregut financiar dhe rritja ekonomike: rasti i Amerikës Latine dhe Karaibeve. Rishikim i Ekonomisë së Zhvillimit, 13 (2), 288- 303).

Banka Botërore (2003), “Albania Poverty Assessment”, Human Development Sector Unit Europe and the Central Asian Republics, Washington, DC, Report No. 26213-AL (“Vlerësimi i Varfërisë në Shqipëri”, Njësia e Sektorit të Zhvillimit Njerëzor për Europën dhe Republikat e Azisë Qendrore, Raporti i Uashington DC Nr. 26213-AL)

Banka Botërore (2010), “Albania - Country partnership strategy for the period FY11-FY14” (“Strategjia e partneritetit vendor për Shqipërinë për periudhën FY11- FY14”). Washington, DC: Banka Botërore.

<http://pubdocs.worldbank.org/en/550271590827524462/RER-Education-COVID-ALB.pdf>
<http://pubdocs.worldbank.org/en/550271590827524462/RER-Education-COVID-ALB.pdf>

SITUACIONI PËRFUNDIMTAR PËRMBLEDHËS I SHPENZIMEVE TË PROJEKTIT

Nr. i artikullit	Emërtimi i artikullit	Fonde (nëLekë)	
		Plan	Fakt
		nga AKKSHI	
230	Shpz. për rritjen e Aktiveve të Qëndrueshme të patrupëzuara		
	Honorare pwr trajnimet e kryera	498,000	498,000
	Shpenzime administrative kancelari	10,000	0,00
	Shpenzime seminare/konferenca (materiale)	20,000	0,00
	Publikime: Dokumenta të prodhuara në kuadër të konferencave shkencore të parashikuara në projekt (përmbledhje abstraktesh, etj, me ISBN, ISSN)	3,000	0,00
	Totali	----	----
231	Shpz. për rritjen e Aktiveve të Qëndrueshme të trupëzuara		

	Totali	531,000	498,000

Drejtuesi i Projektit
Dr. Erinda Papa

Administratori i Universitetit
Petrika Petro

Drejtues i Zyrës së Financës
Xhovani Saraci

Drejtuesi i Agjencisë Ekzekutuese
Rektori i Universitetit / Drejtori i Përgjithshëm
Prof.dr. Dhimitri Bello

SKEDË INFORMATIVE

E RAPORTIT SHKENCOR (STUDIMIT) PËR PROJEKTET QË FINANCOHEN NË KUADRIN E PROGRAMEVE KOMBËTARE TË KËRKIMIT DHE ZHVILLIMIT

1. Titulli i projektit (studimit). Nga projekti drejt të mësuarit me kompetencën digjitale
2. Institucioni përgjegjës. Universiteti “Fan S. Noli”, Departamenti i Gjuhëve të Huaja
3. Vendndodhja e studimit. Rajoni Korçë
4. Drejtuesi shkencor i projektit (studimit) dhe bashkëpunëtorët shkencor.

Dr. Erinda Papa – Drejtues
Dr. Eriola Qafzezi – Bashkëpunëtor
Phd. Daniela Stoica - Bashkëpunëtor

5. Periudha e realizimit të projektit.

Tetor 2021 – Shtator 2023

6. Numri i faqeve të studimit.
7. Numri i ilustrimeve (figura, harta, etj.).
8. Fjalët kyç.

Edukimi digjital, kompetencat e të diplomuarve, tregu i punës, trajnim dhe kualifikim, mjedis virtual i të nxënësve

9. Oponenca shkencore e studimit (minimum 2)

Prof.dr. Dhimitri Bello
Dr. Alda Cicko

10. Përmbledhje për përmbajtjen e studimit me jo më shumë se 1000 karaktere (rreth 10-15 rreshta).

Një numër i madh mësuesish në rajonin e Korçës po përdorin ose dëshirojnë të përdorin praktika inovative që përfshijnë teknologji digjitale. Sidoqoftë, qëllimet e tyre të mira mund të pengohen nga aftësitë e kufizuara digjitale që ata kanë. Hezitimi i tyre ndër vite për të investuar kohën e nevojshme në këtë drejtim, duke zvogëluar kështu mundësinë e përfitimit nga efektet pozitive të praktikave të tilla, u pa sidomos me situatën e shkaktuar nga Covid-19. Ky projekt i vendosur në fokust të studimit mundohet të shfrytëzojë potencialin e mësuesve si aktorët kryesorë të ndryshimit. Efektiviteti i burimeve arsimore teknologjike është i lidhur pazgjidhshmërisht me kontekstin dhe cilësinë e përdorimit të tyre. Pjesëmarrja e mësuesve në zhvillimin e këtyre mjeteve arsimore dhe mbështetja për zhvillimin e aftësisë së tyre për t'i përdorur ato janë çelësi për kalimin e suksesshëm të sistemit arsimor në digjital.

Mësuesit, profesionistët jomësimdhënës dhe personeli administrativ i institucioneve mbështetëse arsimore kanë pasur gjithmonë nevojë për trajnim dhe orientim, por këta faktorë janë gjithnjë e më të rëndësishëm sot, pasi lidhen drejtpërdrejt me aftësinë e tyre për t'u bërë ballë sfidave të kohës dhe kërkesave të tregut. Ne duhet të vazhdojmë të trajnojmë mësuesit dhe ekipet arsimore në përdorimin e teknologjive digjitale dhe të përmirësojmë orientimet për ndarjen e ekspertizës në institucionet arsimore.